



Ministria e Tregtisë dhe Industrisë / Ministry of Trade and Industry/
Ministrastvo Trgovine i Industrije

Departamenti i Tregtisë
Politika Tregtare

REFERENCE:	07				
PËR/ZA/TO:	Zyrën e Informimit				
NGA/OD/FROM:	Zef Dedaj– Koordinator i Politikës Tregtare				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti Vjetor mbi rezultatet nën-grupet punuese të Politikës Tregtare				
Nr. i zyrës: Br. kancelarie: Room No.:	112a	Lokacioni: Kucni: Extension:	Rr “Muharrem Fejza” p.n Lagja Spitalit 10000 Prishtinë/ Republika e Kosovës	Data: Datum: Date:	26.12.2012
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					x

Raporti Vjetor mbi rezultatet e Nën-Grupeve punuese të Politikës Tregtare gjatë vitit 2012:

Gjatë këtij viti është mbajtur takimi i radhës i Grupit Punues për Politikë Tregtare (GPPT), i përberë nga përfaqësues të lartë të Institucioneve Qeveritare, përfaqësues të lartë nga zyra e Komisionit Evropian në Kosovë, përfaqësues të Komunitetit të Biznesit, Shoqatave të Biznesit, Donatoreve dhe Shoqërisë Civile. Në këtë takim janë trajtuar këto çështje: Raportimi mbi aktivitetet e Nëngrupeve Punuese të Politikës Tregtare dhe planet për të ardhmen, aspektet tregtare të ndërlidhura me MSA, si dhe projektet e ndërlidhura me Tregti. Po ashtu janë mbajtur edhe takimet e 5 nëngrupeve punuese, të cilat janë të themeluara në kuadër të Politikës, ku të cilat bashkëkryesohen nga një përfaqësues i Institucioneve Publike, dhe nga një përfaqësues nga komuniteti i bizneseve. Sa i përket nëngrupit punues të bujqësisë deri me tani janë mbajtur 3 takime, ku edhe janë trajtuar dhe adresuar për zgjidhje këto çështje: është zgjedhur rasti lidhur me importimin e mishit të pulës nga Sllovenia, i cili ishte konstatuar se kishte aplikim të çmimit dumping, është zgjidhur problemi lidhur me rastin e vonesave për marrjen e Certifikatave sanitare për eksport gjatë ditëve të vikendit, është në procedure të zgjidhjes rasti i ngritur lidhur me Importimin e koncentratit nga Serbia, i cili është konstatuar se importohet më çmime të ulëta dhe më një cilësi të dobët, ku kërkohet vendosja e TVSH-se për këtë produkt, ndërsa një çështje tjetër që është ngritur na takimin e fundit dhe e cila pritet të adresohet për zgjidhje është Certifikata për autorizim të produkteve për mbrojtjen e bimëve. Po ashtu sa i përket nëngrupit punues të industrisë deri me tani janë mbajtur 2 takime, ku në kuadër të këtyre takimeve janë trajtuar këto çështje: Çështja e kufizimeve tregtare më BE (Kuotat), ku me kërkesë të bizneseve është bere një prezantim lidhur me “Zhvillimin i Politikës Fiskale”, është ngritur çështja lidhur me energjinë elektrike si: rimbursimi - mungesa dhe shtrenjtimi, ku po ashtu është ngritur çështja e pagesës së TVSH-se për lëndën e parë dhe lendet djegëse, duke aluduar për nevojën e heqjes së këtyre. Ndërsa lidhur me takimin e nëngrupit punues për Lehtësimin e Tregtisë deri me tani janë mbajtur 3 takime, ku dhe janë trajtuar këto tema: çështja lidhur me Legjislacioni mbi Tregtinë e Jashtme, është diskutuar lidhur me orarin i punës së Doganës së Kosovës, ku është kërkuar nga nëngrupi punues qe te realizohet një orar me gjatë, po ashtu me qëllim të informimit të bizneseve është bere prezantimi lidhur me “Procedurat më ndikim Ekonomik”, është ngritur nga bizneset çështja

lidhur me garancionet bankare, ku lidhur me këtë është bere një prezantim nga Asociacionet Bankare, ku në takimin e ardhshme do të behet i njëjti prezantim nga kompanitë e sigurimeve, me qëllim që të behet krahasimi i tyre, si dhe kemi pranuar një kërkesë lidhur me çështjen e përfaqësive të bizneseve jo rezidente, e cila se shpejti do të adresohet për zgjidhje. Ndërsa lidhur me shërbime janë mbajtur 3 takime të nëngrupit punues, ku është bere një prezantim nga përfaqësuesi i Ministrisë së Infrastrukturës lidhur me “Pengesat që paraqiten në Transportin rrugor”, po ashtu është bere edhe një prezantim nga një përfaqësues i projektit të Komisionit Evropian lidhur me Tregtinë Ndërkombëtare në Shërbime dhe rëndësia e Shërbimeve për Ekonominë e Kosovës”, si dhe është trajtuar dhe diskutuar lidhur me mundësitë për fillimin e negociatave në Tregtinë me shërbime (CEFTA). Si dhe sa i përket nëngrupit punues për Marrëveshje Tregtare, deri me tani kemi mbajtur vetëm një takim, ku dhe qëllimi i takimit ishte merrja e inputeve nga bizneset lidhur me propozimin për përgatitjen e krijimit të Marrëveshjes së Tregtisë së lirë me Republikën e Turqisë

Veç këtyre jemi në përgatitje të mbajtjes së takimit të Këshillit Ndërmënishtor për Politikë Tregtare, i cili është edhe mekanizmi më i lartë i Politikës Tregtare.